



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-136**

**PËR REGJISTRIMIN E PENGUT NË REGJISTËR PËR SENDET E  
LUAJTSHME**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ REGJISTRIMIN E PENGUT NË REGJISTËR PËR SENDET E  
LUAJTSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj përcaktohet procedura dhe kushtet e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajtshme, ndryshimi, kërkimi i informacionit si dhe administrimi i regjistrit të pengut.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për të gjitha transaksionet ose të drejtat që sipas ligjeve të Kosovës mund të regjistrohen në regjistrin e pengut.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria përkatëse e Tregtisë dhe Industrisë;

1.2. **Pengu** - krijimi i ndonjë interesi mbi pasurinë e luajtshme ose mbi ndonjë të drejte me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për ta marrë në posedim atë pasuri ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë obligimi ekzistues dhe të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut, të përcaktuar më Ligjin për Pronësi dhe të drejta të tjera sendore.

1.3. **Pengdhënës** – personi që ka detyrimin dhe që ka në pronësi objektin e pengut;

1.4. **Pengmarrës** – personi në emër të të cilit vendoset pengut;

1.5. **Sendet e luajtshme** - objektet trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin. Sendet fizike që nuk janë trupore, siç janë drita ose energjia janë pasuri jotrupore (të paprekshme) të përcaktuar më Ligjin për Pronësi dhe të drejta të tjera sendore.

1.6. **Person** - çdo person fizik ose juridik;

1.7. **ARBK** - nënkupton Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë;

1.8. **Spektori** - Spektori për regjistrimin e pengut në kuadër të ARBK-së që menaxhon dhe operon me SRP-në dhe të gjitha procedurat e lidhura me regjistrimin dhe marrjen e informacionit nga SRP;

1.9. **Regjistri i pengut** - regjistri elektronik ku evidentohen dhe ruhen të gjitha të dhënat për sendet të luajtshme;

1.10. **Sistemi i regjistrimit të pengut (SRP)** – sistemi kompjuterik i Regjistrimit të Pengut të përcaktuar me këtë ligj;

1.11. **Sistemi i vjetër i regjistrimit të pengut (SVRP)** - sistemi i vjetër i Regjistrimit të Pengut që ka ekzistuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji;

1.12. **Regjistrim** – regjistrimi i të dhënave të transferuara në regjistrin e pengut përmes SRP, si regjistrim të ri ose si ndryshim i ndonjë regjistrimi;

1.13. **Regjistrim i ri** – çdo regjistrim i regjistruar në SRP që nuk ka qënë i regjistruar në SVRP;

1.14. **Regjistrim i vjetër** – regjistrim që ka qënë i regjistruar në SVRP.

1.15. **Certifikata e regjistrimit të pengut (CRP)** – dokument elektronik i lëshuar nga SRP në formë të konfirmimit të regjistrimit apo rezultatit të kërkimit;

1.16. **Ekstrakt nga kompjuteri** – imazh i prodhuar në mënyrë elektronike nga SRP që përdoret me qëllim të lehtësimit të transferimit të të dhënave në regjistrin e pengut ose për shikimin e të dhënave që ekzistojnë në regjistrin e pengut;

1.17. **Identifikimi** - numri personal i letërnjoftimit të personave fizik, numri i regjistrimit të biznesit i lëshuar nga ARBK për personat juridik si dhe për mallrat me numër serik, njëzet e pesë (25) karakteret e fundit alfa-numerike të numrit serik pa pikësim, viza lidhëse, ndarëse apo shenja tjera, të shënuara ose të vendosura nga ana e prodhuesit;

1.18. **Llogaria e Përdoruesit** – abonim elektronik i ofruar nga SRP i cili ofron qasje në shërbimet e regjistrimit të pengut;

1.19. **Pronari i llogarisë së përdoruesit** – personi në emër të të cilit është e regjistruar llogaria e përdoruesit;

1.20. **Mallra me numër Serik** – sende e luajtshme që specifikohen në aktin nënligjor;

1.21 **Sende të tjera të luajtshme** - sendet e luajtshme që nuk janë të përfshira në definicionin e mallrave me numër serik.

#### **Neni 4**

#### **Spektori për regjistrimin e pengut**

1. Spektori për regjistrimin e pengut është në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë – MTI.
2. Organizimi dhe funksionimi i Spektorit të regjistrimit të pengut rregullohet me akt nënligjor për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

#### **Neni 5**

#### **Detyrat e Spektorit**

1. Spektori për regjistrimin e pengut regjistron dhe menaxhon informacionin lidhur me pengun në pajtim me dispozitat dhe kërkesat e këtij ligji dhe është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj.
2. Spektori për regjistrimin e pengut udhëheqë me procedurat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin më efikas të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me:
  - 2.1. regjistrimin e pengut përmes SRP-së;
  - 2.2. kërkimin e informacioneve përmes SRP-së;
  - 2.3. lëshimin e CRP-ve, dhe
  - 2.4. kryerjen e të gjitha funksioneve tjera që i janë dhënë Spektorit në bazë të këtij ligji.

3. Sektori punon në bazë të SRP-së përmes internetit, duke respektuar rregullat ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë për sigurinë e informacionit elektronik, gjatë lëshimit të dokumenteve elektronike dhe certifikatave të regjistrimit, si dhe për njoftimet tjera dhe komunikatat.

4. Sektori i pengut është i detyruar të procedojë shërbimet e tij vetëm përmes SRP-së, për të mbajtur të dhënat e plota, të sakta dhe aktuale.

## **Neni 6** **Taksa për shërbimet**

1. Sektori përcakton një taksë për shërbimet e ofruara të cilat do të rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.

2. Pronari i llogarisë së përdoruesit do të depozitojë para në cilëndo llogari të caktuar të Sektorit për regjistrim të pengut me qëllim të pagesës ndaj regjistrimit të pengut. pasi pronari i llogarisë së përdoruesit depoziton para në llogarinë bankare të regjistrimit të pengut, regjistri i pengut do të kreditojë llogarinë e përdoruesit me shumën e depozituar.

3. Regjistri i pengut duhet t'i kthejë fondet e pashfrytëzuara nga një llogari e përdoruesit vetëm pronarit të llogarisë së përdoruesit dhe atë me rastin e mbylljes së llogarisë së përdoruesit.

4. Të gjitha të hyrat nga taksat e mbledhura nga Sektori derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 7** **Mbajtja e të dhënave**

Sektori duhet të mbajë kopje elektronike të arkivit të të gjitha informacioneve të regjistruara në SRP në përputhje me ligjin në fuqi.

## **Neni 8** **Llogaria e përdoruesit dhe pronarit të llogarisë së përdoruesit**

1. Sektori do të caktojë llogarinë e përdoruesve përmes SRP-së.

2. Kushtet për llogari të përdoruesit janë si vijon:

2.1. të aplikojë në internet përmes SRP-së dhe,

2.2. personi të plotësojë kushtet dhe kërkesat që parashihen në këtë ligj.

3. Sektori do të ofrojë shërbimet e tij çdo personi që i është lejuar të ketë llogari të përdoruesit me fonde të mjaftueshme në llogari, për të paguar taksat për shërbimet e kërkuara, siç parashihet në SRP.

4. SRP-ja do t'i japë pronarit të llogarisë së përdoruesit arsyet e refuzimit të një regjistrimi nga SRP-ja.

### **Neni 9** **Informacioni i llogarisë së përdoruesit**

Sektori do të ketë qasje në SRP lidhur me informacionet për çdo pronar të llogarisë së përdoruesit si dhe për të gjitha transaksionet e bëra përmes llogarisë së përdoruesit të tij/saj.

### **Neni 10** **Natyra administrative e regjistrimit të pengut**

1. Regjistrimi përmes SRP-së është vetëm veprim formal, informativ dhe administrativ. Sektorit nuk do të verifikojë informacionin e përmbajtur në çdo regjistrim.
2. Pronari i llogarisë së përdoruesit është plotësisht përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar si rezultat i informacionit të regjistruar në SRP përmes llogarisë së përdoruesit të tij/saj.
3. Pronari i llogarisë së përdoruesit konsiderohet se ka autorizim të plotë për të krijuar, ndryshuar ose anuluar një regjistrim të bërë efektiv përmes llogarisë së përdoruesit të tij.

### **Neni 11** **Korrigjimi i gabimeve**

1. Sektori nuk do të përmirësojë gabimet vetëm nëse parashihet ndryshe me ligj.
2. Pronari i llogarisë së përdoruesit është plotësisht përgjegjës për gjithë informacionin e dorëzuar përmes SRP-së.

### **Neni 12** **Shqyrtimi i çështjeve kontestuese**

1. Personi që konsideron se Sektori ose një zyrtar i punësuar aty nuk është duke i përmbushur kushtet e parapara nga ky ligj mund të dorëzojnë një ankesë Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve.
2. Kryeshefi është i autorizuar dhe përgjegjës për të shqyrtuar rastin dhe t'i kërkojë Udhëheqësit të regjistrimit të pengut të ndërmarrë masat e nevojshme për zgjidhjen e këtij rasti.
3. Nëse nuk ka zgjidhje brenda tri (3) dite pune nga pranimi i kërkesës, personi mund t'i drejtohet Komisionit për shqyrtim të ankesave në kuadër të ARBK-së.

**Neni 13**  
**Shkëmbimi i të dhënave, dokumenteve dhe informacionit**

Ministria mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me institucionet financiare për mbledhje, mirëmbajtje, shpërndarje të zakonshme të të dhënave dhe informacionit vetëm siç parashihet në SRP.

**Neni 14**  
**Objekti i pengut të regjistruar**

Objekt i pengut të regjistruar mund të jetë çfarëdo sendi i luajtshëm me vlerë pasurore si dhe ndonjë e drejtë e cila mund të bartet në mënyrë të ligjshme.

**Neni 15**  
**Përshkrimi i sendeve të luajtshme në një regjistrim**

1. Përshkrimi i sendeve të luajtshme në një regjistrim është i vlefshëm vetëm nëse e bënë identifikimin e pasurisë.

2. Përshkrimi i sendeve tjera të luajtshme mund të jetë, por jo të kufizohet, si më poshtë:

2.1 të gjitha sendet e luajtshme të pengdhënësit që ka në pronësi në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes së pengut dhe të gjitha sendet e luajtshme të pengdhënësit të siguruara më vonë.

2.2. të gjitha sendet e luajtshme të ardhshme të pengdhënësit por jo sendet e luajtshme të paprekshme.

2.3. të gjithë inventarin e pengdhënësit.

3. Kur regjistrimi ka të bëjë me një mall me numër serik, që nuk mbahet për shitje në qarkullimin normal të biznesit të shitësit, kjo do të përfshihet në vendet e caktuara në ekran:

3.1. identifikimi i mallit me numër serik;

3.2. emri i prodhuesit dhe viti i prodhimit të mallit me numër serik.

4. Kur regjistrimi ka të bëjë me sende tjera të luajtshme, përshkrimi do të ofrohet në vendin e caktuar në ekranin e SRP-së.

**Neni 16**  
**Vlefshmëria e regjistrimit të pengut**

1. Regjistrimi është i pavlefshëm, nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e këtij ligji.

2. Një regjistrim i ri është i vlefshëm vetëm nëse për të është kryer pagesa.

3. Regjistrimi është i vlefshëm për çdo person, nëse regjistrimi paraqitet në një raport si rezultati i kërkimit që është bërë në bazë të identifikimit të këtij personi.

4. Regjistrimi është i vlefshëm për çdo mall me numër serik, nëse regjistrimi paraqitet në një raport si rezultat i kërkimit të bërë në bazë të identifikimit të këtij malli me numër serik.

5. Informacioni i mëposhtëm duhet të përfshihet në një regjistrim të bërë përmes SRP-së:

5.1. identifikimin e pengmarrësit;

5.2. identifikimin e pengdhënësit;

5.3. përshkrimin e sendeve të luajtshme siç parashihet në këtë ligj.

6. Informacioni i mëposhtëm nuk është e domosdoshme të përfshihet në regjistrim:

6.1. çfarëdo detaji i kontratës;

6.2. çfarëdo detaji për detyrimin e siguar përfshirë vlerën maksimale;

6.3. vlerën e sendeve të luajtshme të përshkruar në regjistrim;

6.4. nënshkrimin e pengdhënësit.

### **Neni 17**

#### **Përmbajtja e bazës së të dhënave të regjistrit të pengut**

1. Sistemi i regjistrit të pengut përmban informacion për:

1.1. personat e regjistruar si pengmarrës dhe pengdhënës;

1.2. informacionin që përshkruan sendet e luajtshme të regjistruara;

1.3. informacionin për përdoruesit e regjistrit të pengut;

1.4. të dhënat statistikore dhe financiar për operimin e regjistrit të pengut;

1.5. dosjen e ditarit të të gjitha veprimeve në regjistër.

### **Neni 18**

#### **Kushtet dhe procedurat e regjistrimit në regjistrin e pengut**

1. Regjistri i pengut procedon kërkesat për regjistrime, ndryshime dhe kërkime nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

1.1. personi që kërkon të kryej regjistrimin ka një llogari të përdoruesit;

1.2. kërkesa të dorëzohet në formë elektronike duke përdorur SRP;

1.3. llogaria e përdoruesit ka fond të mjaftueshëm për të mbuluar taksat për regjistrim; dhe,

1.4. personi që bënë regjistrimin të dorëzon të gjithë informacionin e kërkuar sipas këtij ligji dhe SRP-së.

2. Regjistrimet dhe ndryshimet e regjistrimeve duhet të parashtrihen në gjuhët zyrtare në Kosovë.

### **Neni 19** **Konfirmimi i regjistrimit**

1. Kur një pronar i llogarisë së përdoruesit dorëzon një regjistrim përmes SRP-së, regjistri i pengut do të japë përmes SRP-së një raport elektronik për konfirmim të regjistrimit.

2. Pronari i llogarisë së përdoruesit duhet t'i dorëzojë me kërkesë te çdo personi që identifikohet si pengdhënës në regjistrimet e tij, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh kalendarike, një kopje elektronike apo kopje fizike të konfirmimit të regjistrimit pas datës së regjistrimit.

3. Pronari i llogarisë së përdoruesit që dështon që të sigurojë njoftimin personit sipas paragrafit 2. të këtij neni, do të paguaj një gjobë, e cila do të derdhet në buxhetin e Republikës së Kosovës. Personi ka të drejtë t'i drejtohet Sektorit të regjistrimit të pengut dhe, Sektori është i detyruar t'ia siguroj personit një kopje elektronike apo kopje fizike të konfirmimit të regjistrimit.

4. MTI me akt nënligjor cakton shumën e gjobave.

### **Neni 20** **Rezultati i Kërkimit**

1. Kur një pronar i llogarisë së përdoruesit dorëzon një kërkesë elektronike për kërkim përmes SRP-së, regjistri i pengut do të japë përmes SRP-së, një raport elektronik të rezultatit të kërkimit që tregon të gjitha regjistrimet që ekzistojnë sipas kriterëve të kërkimit.

2. Kur një pronar i llogarisë së përdoruesit dorëzon një kërkesë elektronike për kërkim përmes SRP-së në bazë të numrit të regjistrimit, numrit të kërkimit ose numrit të certifikatës, regjistri i pengut do të prodhojë në mënyrë elektronike dokumentin e regjistruar me këtë numër.

3. Kur personi dorëzon një kërkesë elektronike për kërkim pa pagesë përmes SRP, regjistri i pengut nuk do të japë raport të rezultateve të kërkimit por vetëm të dhenat bazike që ekzistojnë sipas kriterëve të dhëna të kërkimit. Regjistri i pengut nuk jep të dhëna detale në kërkimet pa pagesë.



**Neni 21**  
**Dhënia e çertifikatave të regjistrimit të pengut**

1. Regjistri i pengut do t'i japë një CRP elektronike çdo personi që kërkon atë përmes shfrytëzimit të llogarisë së përdoruesit të tij.
2. Një ekstrakt i CRP-së do të jetë dëshmi e provave para organeve gjyqësore.

**Neni 22**  
**Regjistrimet e vjetra**

1. Ri-regjistrimi i regjistrimit të vjetër në SRP bëhet pa pagesë dhe duhet të bëhet nga entiteti i cili e ka regjistruar regjistrimin e vjetër, bazuar në përzgjedhjen e tyre se cilin regjistrim duan të ri-regjistrojnë.
2. Regjistrimet e vjetra që janë shuar ose përfunduar para se të hy në fuqi ky ligj nuk mund të ri-regjistrohen në SRP.
3. Regjistrimet e vjetra mund të ri-regjistrohen në SRP për periudhën tranzitore brenda gjashtë (6) muajve duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Rregjistrimet e vjetra kanë përparësi mbi rregjistrimet e reja vetëm nëse regjistrimet e vjetra ri-regjistrohen në SRP gjatë periudhës tranzitore.
5. Rradha e përparësisë mes regjistrimeve të vjetra nuk ndryshon me këtë ligj pa marrë parasysh nëse ato ri-regjistrohen ose jo.
6. Regjistrimet e vjetra janë të vlefshme mes pengdhënësit dhe pengmarrësit edhe nëse nuk ri-regjistrohen në SRP.
7. Ri-regjistrimi i regjistrimit të vjetër duhet të përfshijë në hapësirën e sendeve të luajtshme të tjera, informatat si në vijim:
  - 7.1. fjalinë hyrëse “Ri-regjistrim”;
  - 7.2. numrin e regjistrimit të regjistrimit të vjetër, dhe
8. Përshkrimi i pengdhënësit, pengmarrësit dhe mallit me numër serik për ri-regjistrim duhet të bëhet sipas këtij ligji.
9. Të gjitha rregjistrimet e vjetra të cilat ri – regjistrohen në SRP kanë një periudhë maksimale vlefshmërie prej tre (3) viteve, kurse pas kësaj periudhe, vazhdimi i vlefshmërisë bëhet me pagesë.
10. Të gjitha regjistrimet valide të vjetra mund të barten në menyrë automatike nëse kërkojnë Institucionet financiare, përgjegjësinë për saktësinë e të dhenave ekzistuese e bartin këto institucione.

11. Sektori është përgjegjës për transferimin automatike të regjistrimeve të vjetra në SRP.

### **Neni 23**

#### **Kohëzgjatja e regjistrimit të pengut**

Një regjistrim është i vlefshëm varësisht prej zgjedhjes së pronarit të llogarisë së përdoruesit përmes përdorimit të SRP-së.

### **Neni 24**

#### **Ndryshimi i regjistrimit të pengut**

1. Regjistrimi mund të ndryshohet nga pronari i llogarisë së përdoruesit nga i cili është bërë regjistrimi.

2. Duke përdorur SRP-në, mund të bëhen ndryshimet e mëposhtme në regjistrime:

- 2.1. vazhdimi i regjistrimit;
- 2.2. shlyerja e regjistrimit;
- 2.3. shlyerja e pengmarrësit;
- 2.4. shlyerja e pengdhënësit,
- 2.5. shlyerja e mallrave me numër serik;
- 2.6. ndryshimi i sendeve tjera të luajtshme;
- 2.7. shtimi i pengmarrësit;
- 2.8. shtimi i pengdhënësit dhe
- 2.9. shtimi i mallrave me numër serik.

### **Neni 25**

#### **Kërkesa për informacion ose për ndryshim të regjistrimit**

1. Personi që shfaqet në një regjistrim si pengdhënës ka të drejtë të kërkojë nga pronari i llogarisë së përdoruesit të shlyej ose të korrigjojë një regjistrim të pavlefshëm.

2. Personi që shfaqet në një regjistrim si pengdhënës mund të kërkojë nga pronari i llogarisë së përdoruesit t'i dorëzojë cilido person një njoftim informativ, duke përfshirë:

- 2.1 një kopje të kontratës së pengut sipas së cilës është bërë regjistrimi;
- 2.2. një dokument që tregon shumën e mbetur të detyrimit nga data e kërkesës.

3. Pronarit të llogarisë, të cilit i është bërë kërkesa sipas këtij neni, do të përmbushë kërkesën brenda shtatë (7) ditësh kalendarike pas pranimit të kërkesës nga ai.
4. Kur pronari i llogarisë të cilit i është bërë kërkesa sipas këtij neni, pa arsye dështon të përmbushë kërkesën, pengdhënësi mund t'i drejtohet gjykatës kompetente që regjistrimi të ndryshohet apo anulohet.
5. Kur vendimi i gjykatës kompetente i dorëzohet Sektorit, regjistrimi ndryshohet ose shlyhet sipas vendimit të Gjykatës.
6. Pronari i llogarisë së përdoruesit që dështon t'i përmbahet këtij neni, është përgjegjës për gjobat e parapara me aktet nënligjore dhe për dëmet e shkaktuara si rezultat i dështimit.
7. Personi që bën kërkesë sipas këtij neni ka të drejtë që gjatë një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore të marrë pa pagesë dy (2) njoftime informuese nga pronari i llogarisë që ka marrë kërkesën.
8. MTI me akt nënligjor cakton taksat për shërbime shtesë sipas këtij neni.

#### **Neni 26** **Rradha e regjistrimeve**

1. Regjistrimet janë të ruajtura me renditje sipas datës dhe kohës kur janë dorëzuar përmes SRP-së.
2. Regjistrimi i pengut duhet të jetë në pajtim me të dhënat e përcaktuara në kontratë.

#### **Neni 27** **Shuarja**

Regjistrimi përfundon automatikisht nga SRP me përfundimin e periudhës së regjistrimit.

#### **Neni 28** **Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera**

Në çështjet, të cilat kanë të bëjnë me procedurën e regjistrimit në regjistrin e pengut dhe të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit për Pronësi dhe të drejtat tjera sendore.

#### **Neni 29** **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij ligji, nxjerrë akte nënligjore brenda gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 30**

#### **Aktet nënligjore të aplikueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore**

1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, aktet nënligjore të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi si në vijim:

1.1. Udhëzim administrativ nr.2009/07 për organizimin dhe funksionimin e zyrës së pengut;

1.2. Udhëzim administrativ nr.2009/08 për përcaktimin e tarifave për regjistrimet dhe shërbimet tjera të kryera nga zyra e pengut.

### **Neni 31**

#### **Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja Nr.2001/5 dhe Rregullorja 2001/32 si dhe çdo dispozitë e Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore që është në kundërshtim me këtë ligj.

### **Neni 32**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-136**  
**5 nëntor 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**